



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS KLINË

Numri i lëndës: 2023:102261

Datë: 19.04.2024

Numri i dokumentit: 05592825

NË EMËR TË POPULLIT

P.nr. 74/23

GJYKATA THEMELORE PEJË – DEGA NË KLINË, Departamenti i Përgjithshëm Penal, me pjesëmarrjen e gjyqtarës së vetme gjykuese Sabrije Rraci, me bashkëpunëtore profesionale Albulena Morina-Lulaj, në çështjen penale ndaj personit juridik ‘‘L.C’’, SH.P.K (shoqëri me përgjegjësi të kufizuar), me pronar A . B, për shkak të veprës penale ndotja, degradimi ose shkatërrimi i mjedisit nga neni 338 par. 1 të KPRK-së, dhe të pandehurit A. B nga fshati K, K. P, për shkak të veprës penale ndotja, degradimi ose shkatërrimi i mjedisit nga neni 338 par. 1 të KPRK-së, duke vendosur lidhur me Aktakuzën e Prokurorisë Themelore në Pejë PP/II.nr.652/2023 të dt.28.04.2024, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me datë 19.03.2024, në prezencë të Prokurorit të Shtetit Ramiz Buzhala, nga Prokuroria Themelore në Pejë, i pandehuri A. B, pronar dhe përfaqësues i personit juridik ‘‘L.C’’, SH.P.K (shoqëri me përgjegjësi të kufizuar) dhe mbrojtësi i tij Av. Shaban Shala, ndërsa me datë 19.04.2024, mori dhe përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

1.Personit juridik ‘‘L.C’’, SH.P.K (shoqëri me përgjegjësi të kufizuar), me seli në P, me numër të certifikatës se regjistrimit, me pronar A. B.

2.A. B, i lindur me, në fshatin K, K P, ku edhe tani jeton, Rr. ‘‘M. V’’, pn, i biri i M. B dhe nënës Sh. B e gjinisë G me numër personal:, ka të kryer shkollën e mesme, i martuar, baba i 3 fëmijëve, i pa punë, i nacionalitetit shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, mbrohet në liri.

Personi juridik ‘‘L. C’’, SH.P.K është PËRGJEGJES

Për shkak se:

Me dt. ,ne kohe te pavërtetuar, në fsh. P. i E. K. K, me dashje ka shkelur nenin 80 të Ligjit për Minierat dhe Mineralet 03/L-163, në atë mënyrë qe i pandehuri ushtron aktivitet te jashtëligjshëm, pa posedim te licencës i cili është ne kundërshtim me dispozitat materiale të ligjit për Miniera dhe minerale, edhe pse ka qene i obliguar ti përmbahet kushteve teknike te licencimit ne baze te rregullave teknike te licencimit nuk i shfrytëzon resurset minerare ashtu siç parashihet në përputhje me standardet evropiane, si dhe duke përdorur forcën mekanike me qellim të shfrytëzimit të resurseve minerare në kundërshtim me rregullat dhe pajisjet të cilat shërbejnë për mbrojtjen nga rreziqet, ndotje, degradim ose shkatërrim të mjedisit e duke shkaktuar dëme ne shumen prej 5.778.28 euro,

me çka ka kryer vepër penale “*Ndotja, degradimi ose shkatërrimi i mjedisit*” nga neni 338 par. 1 të KPRK-së.

I pandehuri A.B është FAJTOR

Për shkak se:

Me dt., ne kohe te pavërtetuar, në fsh. P. i E. K. K, me dashje ka shkelur nenin 80 të Ligjit për Minierat dhe Mineralet 03/L-163, në atë mënyrë qe i pandehuri në vendin e lartcekur ushtron aktivitet te jashtëligjshëm, pa posedim te licencës i cili është ne kundërshtim me dispozitat materiale të ligjit për Miniera dhe minerale, edhe pse i pandehuri ka qene i obliguar ti përmbahet kushteve teknike te licencimit ne baze te rregullave teknike te licencimit nuk i shfrytëzon resurset minerare ashtu siç parashihet në përputhje me standardet evropiane, dhe përdor forcën mekanike me qellim të shfrytëzimit të resurseve minerare në kundërshtim me rregullat dhe pajisjet të cilat shërbejnë për mbrojtjen nga rreziqet, ndotje, degradim ose shkatërrim të mjedisit e duke shkaktuar dëme ne shumen prej 5.778.28 euro,

me çka ka kryer vepër penale “*Ndotja, degradimi ose shkatërrimi i mjedisit*” nga neni 338 par. 1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata konform të neneve 4, 7, 8, 9, 10, 17, 38, 39, 40, 42, 43, 46, 47, 48, 49, 50, 69, 70, 338 par 1 të KPRK-së, si dhe nenit 365, 369, 449 të KPRK-së, personin juridik dhe të pandehurin e :

GJYKON

Personin juridik ‘L. C’, SH.P.K, i shqiptohet:

Dënim me gjobë, në shumë prej 800 (tetëqindë) euro, të cilin dënim obligohet që ta paguajë në afat prej 1 (një) muaj pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse i pandehuri nuk e paguan gjobën e shqiptuar sipas afatit të dhënë, e njëjta gjobë do të zëvendësohet në dënim me burg, konform nenit 46 par.3 të KPRK-së, ku një ditë burgim do ti llogaritet në 20 euro të gjobës.

Të pandehurit A. B i shqiptohet:

Dënim me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve, të cilin dënim i pandehuri nuk do të ta mbaj në rast se i njëjti në afat prej (një) viti nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale.

I pandehuri A. B, obligohet që në emër të paushallit gjyqësore të paguajë shumën prej 20 (njëzetë) euro, si dhe në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej 20 (njëzetë) euro, të gjitha këto në afat prej 30 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm ka ngrit aktakuzë me numër PP/II.nr. 652/2023 të datës 28.04.2023, ndaj personit juridik ‘L.C’, SH.P.K, me pronar F.B, , për shkak të veprës penale ndotja, degradimi ose shkatërrimi i mjedisit nga neni 338 par. 1 të KPRK-së, dhe të pandehurit A. B nga fshati K, K P, për shkak të veprës penale ndotja, degradimi ose shkatërrimi i mjedisit nga neni 338 par. 1 të KPRK-së.

Gjykata me datën 19.03.2024, ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar në prezencë të Prokurorit të shtetit Ramiz Buzhala, të pandehurit A. B, pronar dhe përfaqësues i personit juridik ‘L. C’, SH.P.K (shoqëri me përgjegjësi të kufizuar) dhe mbrojtësi i tij Av. Shaban Shala, ku janë njoftuar për të drejtat e tyre në këtë çështje penale, ju është lexuar akuza, ku të njëjtit kanë deklaruar se e kanë kuptuar akuzën dhe nuk kanë nevojë për ndonjë sqarim.

I pandehuri A. B, edhe si person përgjegjës i personit juridik është deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale në aktakuzë për të dy dispozitivat, dhe se është penduar thellë për veprën që i vihet në barrë, i premtoj gjykatës se ne të ardhmen nuk do të përsërisë vepra të tilla, i njëjti deklaron se nuk e ka ditur se është vepër penale, sepse nuk do të kisha kryer një vepër të tillë.

Prokurori i shtetit, lidhur me pranimin e fajësisë nga i akuzuari ka deklaruar se pajtohem me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, për veprën që i vihet në barrë, pasi ky pranim i fajësisë është bërë në mënyrë të vullnetare dhe pa presion duke u mbështetur në provat materiale që gjenden në shkresat e lëndës. i ka propozuar gjykatës që të pranoj pranimin e fajësisë nga i pandehuri për veprën penale që i vihet në barrë, dhe në rastin marrjes së vendimit lidhur me denimin, pranimin e fajësisë ta merr si rrethanë lehtësuese.

Mbrojtësi i të pandehurit Av. Shaban Shala, lidhur me pranimin e fajësisë nga i pandehuri ka deklaruar se: nuk e kundërshtoj me qene se ky është bere nga mendimi i liri dhe pa ndikim nga jashtë, me qene se i mbrojturi i tij ka bere pranimin e fajësisë ku deklaroj se pendohet per veprën e kryer dhe sikur ta dinte se me atë veprim kryen vepër penale nuk do të kishte kryer atë veprim në asnjë menyrë, këtë deklaratë të tij e mbështeti edhe në licencen për hulumtim nga komisioni i pavarur për miniera dhe minerale i vitit 2019, dhe pëlqimit te dhen nga K. K, po ashtu ne vitin 2012, mirëpo nuk ka mundur ta merr vendimin për lirimin e kësaj veprimtarie nga ministria përkatëse me qenes ne fillim ka qene rasti i pandemisë ndërsa me vone e edhe tani nuk ka bord te formuar ne ministri për lejimin e këtyre veprimtarive kjo ka qene arsyeja vetme se i njëjti duke u bazuar ne dy prova te cekura me larte ka menduar se mund t kryerje veprimtarinë deri sa te formohet bordi përkatës dhe me kërkesën e tij ti lirohet kryerja e veprimtarisë përkatëse, për arsyet e cekura i propozoj gjykatës qe me rastin e vendosjes mbi fajësinë dhe sanksionin nga i njëjti ta

merr parasysh pranimin e fajësisë si rrethana lehtësuese, dhe 2 provat e cekura me larte si dhe premtimin e tij se nuk do te kryej vepër te tjetër apo e ngjashme dhe sikur ta kishte dikur se ky veprim i tij bene vepër penale nuk do ta kishte kryer kurrsesi, mendoj se këto te cekura janë te mjaftueshme qe gjykata me rastin e vendosjes ndaj te njëjtit te shqipton një dënim sa me te ulet dhe atë nen minimumin e paraparë me ligje, dhe po ashtu një dënim me gjobe te cilin do ta përmbushë menjëherë posa ta merr aktgjykimin si dhe te merr vendim mbi kthimin e mjeteve te ndaluara nga policia qe i njëjti jam i bindur sipas deklaratës se tij se do ti shet dhe do ti përmbushë obligimet te cilat pasojnë nga ky veprim sepse ne te ardhmen mendon se nuk do te merret me ketë veprimtari po edhe nëse eventualisht ja lejojnë kushtet e jetesës për te ber ekzistimin e jetës

se familjes së tij fare nuk do të vepron apo ti a fillon punës pa i rregulluar të gjitha dokumente përkatës të nevojshme apo ndonjë veprimtarit tjetër.

Në shqyrtimin fillestar dhe publik, gjykata pas dëgjimit të palëve, ka marrë aktvendim me të cilin e ka pranuar fajësinë nga ana e përfaqësuesit të personit juridik "L. C", SH.P.K, dhe nga i pandehuri A. B, i vlerësoi se pranimi i fajësisë paraqet shprehje të lirë të vullnetit të tyre, pasi që e me parë e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të përgjegjësisë dhe të fajësisë.

Gjyqtari i vetëm gjykues është bindur se në seancën e shqyrtimit kryesor nuk ekzistojnë rrethana për hedhjen e aktakuzës nga neni 244 i KPPRK-së, si dhe janë vërtetuar faktet nga neni 242 par. 6 të KPPRK-se, ndërsa aktakuza mbështet në këto prova siç janë: Shënimi zyrtar i policit hetues S. K, e dt.27.03.2023; shënimi zyrtar i policit hetues Rr. G, e dt. 6.03.2023;

3. raporti i policit hetues A. K, e dt. 26.03.2023; urdhëresa për ndërprerjen e punës nga Inspektorati i Punës e dt. 26.03.2023; deklaratat e te dyshuarit A. B, te dt. 26.03.2023 dhe 27.03.2023; vërtetimi mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve e dt. 26.03.2023; inspektimi i punëve e dt. 27.03.2023; kërkesa e stacionit policor në Klinikë për sekuestrimin e përkohshëm të sendeve e dt. 28.03.2023; urdhër i përkohshëm i ndalimit të sendeve e dt. 28.03.2023; fotoalbum i vendit të ngjarjes e dt. 26-29.03.2023; Raport për aktivitete të jashtëligjshme nga ndërmarrja "L. C"SH.P.K", urdhëresë për ndërprerjen e aktivitetit i jashtëligjshëm minerar nr.000151 i dt. 26.03.2023, raporti mbi kalkulimin e vëllimit dt.29.03.2023, raport për operim ilegal dt.27.03.2023, si dhe të behet shikimi në shkresat tjera të lëndës.

Me provat e ofruara, si dhe pranimin e përgjegjësisë dhe të fajësisë nga ana e të pandehurave është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv të aktgjykimit.

Gjykata nuk gjeti rrethana që përjashtojnë ndjekjen penale apo përgjegjësinë penale të personit juridik "L. C", SH.P.K, me seli në Pejë dhe të pandehurit A. B dhe janë penalisht përgjegjës.

Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese në kuptim të nenit 70 par.1, 2 dhe 3, të KPRK-së dhe nenit 10 të ligjit Nr. 04/L-030, për Përgjegjësinë e Personave Juridik për Vepra Penale.

Kështu si rrethana lehtësuese për personin juridik "L. C", SH.P.K, gjykata mori pranimin e përgjegjësisë për veprën e kryer penale, ndërsa rrethana rënduese ndaj të pandehurit gjykata nuk ka gjetur.

Ndërsa si rrethana lehtësuese për të pandehurin A. B gjykata mori pranimin e fajësisë, keqardhjen e shfaqur nga të pandehurit, me parë nuk kanë qenë të dënuara për ndonjë veprë tjetër penale, ndërsa rrethana rënduese ndaj të pandehurit gjykata nuk ka gjetur.

Gjykata çmon se dënimi i shqiptuar është i drejtë dhe i ligjshëm, se është në harmoni me shkallën e përgjegjësisë penale të të pandehurve personit juridik "L. C", SH.P.K, dhe të pandehurit A.B, dhe me intensitetin e rrezikimit apo dëmtimit të vlerës së mbrojtur. Duke gjetur se ky dënim është dënim adekuat me shkallën e rrezikshmërisë së veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të të pandehurave dhe se me këtë dënim ndaj tyre do të arrihet qëllimi i dënimit të paraparë nga neni 38 të KPRK-së, i cili konsiston në parandalimin e të pandehurave nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tyre, të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Konform nenit 449 par. 1 dhe par. 2, nën par 2.9 dhe nenit 36 par.1, 2, 3, nën par.3.1 të ligjit për kompensimin e viktimave të krimit, gjykata ka obliguar të pandehurit secilin veç e veç në pagesën e taksës në shumë prej 20 (njëzet) euro.

Konform nenit 449 par.1 dhe 2, nënpar.2.6, të KPPRK-se, gjykata ka obliguar të pandehurin që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 (njëzet) euro.

Andaj, duke u mbështetur në fakte e parashtruara dhe dispozitat ligjorë nga neni 364 dhe 369 të KPPRK-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË-DEGA KLINË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM
P.nr.74/23 me datë. 19.04.2024

Gjyqtarja Gjykuese:
Sabrije Rraci

Numri i lëndës: 2023:102261
Datë: 19.04.2024
Numri i dokumentit: 05592825

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë te drejte te parashtrojnë ankesë në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh, nga dita e marrjes. Ankesa i dërgohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj Gjykate.